



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME PROCESIN E
DEKLARIMIT TË STATUSIT TË PUNONJËSVE
DHE NËPUNËSVE AKTUALË**

BASHKIA VLORË

Tiranë, Mars 2016

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësit të nëpunësve në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe planit vjetor të mbikëqyrjes, me Vendimin nr. 121, datë 05.11.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë Vlorë.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve të vitit 2015, organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen e re administrative, përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë së Vlorës, përfshin edhe njësi vendore të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, të tilla si Bashkia Orikum, Komuna Novoselë, Komuna Qendër dhe Komuna Shushicë, të cilat, në bazë të ligjit nr. 30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, aktualisht janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Vlorë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njërive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrirë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, “Transferimi i personelit”, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njërive që janë shkrirë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njërive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar, do t’i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Mbikëqyrja u realizua sipas programit të mbikëqyrjes nr. 771/1 prot., datë 05.11.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 771/2 prot., datë 05.11.2015 *“Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”*.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është tematik dhe përfshin verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kanë qënë të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Gentiana Biku, Alda Xhaxhiu, Irma Vani dhe Zamira Mujali, nën drejtimin teknik të Drejtores së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Arbana Basha, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit me shkresën nr. 771/3 prot., datë 02.02.2016, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, rezulton se, projektraporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtori përkatës, me shkresën nr. 803/1 prot., datë 09.02.2016, *“Informacion mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë”*, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 771/4 prot., date 03.03.2016. Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës, por ka pasqyruar disa sqarime në lidhje me gjetjet në projektraport, të cilat janë trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitjen, para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo për një periudhë mbi 1 vit.
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
 - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj., dhe plotësimi i dosjes së personelit sipas kërkesave të ligjit.
3. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit në arkivin e institucionit, si dhe dokumentacioni i ndodhur në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, u realizua një takim me Drejtoreshën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Kryetarin e Bashkisë, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëprezencat dhe borderotë e pagesës së punonjësve për periudhën shkurt 2014 dhe për periudhën tetor 2015.
- U verifikua ligjshmëria e gjithë akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil të lëshuara nga njësi e personelit, për gjithë nëpunësit e bashkisë.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi nr. 1, Aneksi nr. 2 dhe Aneksi nr. 3*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e pandarë e këtij raporti.

Përmbajtja e raportit:

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

a) Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në Bashkinë Vlorë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se fusha e veprimit të tij është çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore dhe njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Institucioni i Bashkisë, është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i cili, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye në bazë të nenit 2 pika 4 të

ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, tashmë i shfuqizuar, ky subjekt është përfshirë në shërbimin civil, gjë e cila është konfirmuar edhe nga neni 2, paragrafi I, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që është aktualisht në fuqi.

Administrimi i shërbimit civil në këtë institucion është bërë mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak Vlorë, në zbatim të nenit 32, germa “ç” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i ndryshuar.

Më poshtë, duke pasur parasysh objektin e mbikëqyrjes, që ka lidhje me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që është data 26.02.2014, po i analizojmë subjektet në mënyrë të detajuar, sipas ligjit të kohës, kur njësitë e sotme administrative, kanë qenë të organizuara si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, me statusin e Bashkive ose Komunave.

a.1) Bashkia Vlorë

Nga analiza e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 66, datë 20.12.2012 “*Mbi Strukturën Organizative të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse – viti 2013*”, të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur ka pasur gjithsej **219** pozicione pune, nga të cilat, **110** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, që përbëjnë rreth **50%** të numrit total të pozicioneve të punës.

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, pozicionet e punës së administratës së Bashkisë Vlorë, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **15** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Drejtor Drejtorie/ Administrator*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **10** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë **85** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Specialist/Inspektor*”.

a.2) Bashkia Orikum, aktualisht Njësia Administrative Orikum

Nga analiza e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar

dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2014 “Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2014”, të Këshillit të Bashkisë Orikum.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur ka pasur gjithsej **55** pozicione pune, nga të cilat, **31** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil, që përbëjnë rreth **56%** të numrit total të pozicioneve të punës.

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve pjesë përbërëse e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, rezulton të jenë **7** pozicione, që i përkasin kategorisë “Drejtor drejtorie”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues është **1** pozicion pune, i cili i përket kategorisë “Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë **23** pozicione pune, të cilat i përkasin kategorisë “Inspektor”.

► Lidhur me këtë njësi administrative është kryer inspektim i veçantë nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, i cili është përfunduar me Vendimin nr.125, datë 24.11.2015 “Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit tematik, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit dhe vlerësimin e rezultateve të punës, në Bashkinë Orikum, aktualisht Njësi Administrative e Bashkisë Vlorë”, në të cilin janë lënë edhe detyrat konkrete për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

a.3) Komuna Novoselë, aktualisht Njësia Administrative Novoselë

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (datë 26.02.2014), kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 121, datë 24.01.2014 të Këshillit të Komunës Novoselë.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **58** pozicione pune, nga të cilat, **13** pozicione pune plotësonin kushtet për t’u përfshirë në shërbimin civil, (që zenë rreth **22%** të numrit total të pozicioneve të punës) kurse pjesa tjetër janë pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të

punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **5** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Përgjegjës Sektori*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **8** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Specialist/Inspektor*”.

a.4) Komuna Qendër, aktualisht Njësia Administrative Qendër

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 3, datë 31.01.2013 të Këshillit të Komunës Qendër.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **70** pozicione pune, nga të cilat, **10** pozicione pune bënin pjesë në shërbimin civil, që zenë rreth **14%** të numrit total të pozicioneve të punës.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Përgjegjës Sektori*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **6** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Specialist/Inspektor*”.

a.5) Komuna Shushicë, aktualisht Njësia Administrative Shushicë

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 22.01.2014 të Këshillit të Komunës Shushicë.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **32** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **6** pozicione bënin pjesë në shërbimin civil, që zënë rreth **18%** të numrit total të pozicioneve të punës.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “Përgjegjës Sektori”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “Specialist/Inspektor”.

► Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe në Komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) si dhe pasi u analizuan ato, rezulton se janë verifikuar gjithsej **170** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga **434** pozicione pune në total.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, **170** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë, Bashkinë Orikum dhe në Komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **22** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie/ Administrator”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **23** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **125** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor”.

Ndërkohë, sipas strukturës së institucionit, në momentin e mbikëqyrjes, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, me Vendimin nr. 24, datë 10.10.2015, “Për miratimin e strukturës organizative tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të varësisë”, rezultojnë në shërbimin civil **114** pozicione pune, nga **338** vende pune në total. Në mënyrë të detajuar, kjo gjëndje është pasqyruar në tabelën Aneks nr. 3 - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil, sipas Strukturës Organizative Tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2015”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e analizuara më sipër, Komisioneri vlerëson se, është bërë një ndarje e drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit.

b) Verifikimi i kushteve ligjore për përfitim të statusit të nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Bashkitë Vlorë dhe Orikum, ashtu dhe ish Komunat, (sot njësi administrative) me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, u konfirmuan në rastin e Bashkisë ose u përfshinë për herë të parë në shërbimin civil në rastin e Komunave, në bazë të nenit 67 të ligjit në fjalë, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, njësia përgjegjëse duhe të bënte deklarin e statusit të punësimit të punonjësve të tyre brenda afateve të përcaktuara në këto akte.

Për kryerjen e këtij procesi, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përcakton në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues”, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “Nëpunësit ekzistues”, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit”, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse, pas verifikimit të procedurës dhe kohëzgjatjes së punësimit”.

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e

shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, grupi i kontrollit verifikoi dhe analizoi të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, kohën e fillimit të punës, organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë efektive në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, (listëprezencën dhe listëpagesën e muajit *shkurt 2014*), si dhe aktet që pasqyrojnë procedurat e rekrutimit për nëpunësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Pas analizës së situatës, lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, duke marrë si kriter procedurën e zbatuar për plotësimin e këtyre pozicioneve, situata rezulton si më poshtë:

b.1) Gjendja e deklarimit të statusit të punësimit në Bashkinë Vlorë dhe Komunat përkatëse në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, data 26.02.2014

b.1.1) Bashkia Vlorë

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) janë evidentuar gjithsej **110** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- në **75** raste, kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, dhe për këtë shkak janë deklaruar nëpunës civilë;
- në **7** raste janë deklaruar nëpunës civilë në periudhë prove, pasi kanë patur më pak se një vit;
- në **14** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit;
- **14** pozicione kanë qënë të lira.

b.1.2) Bashkia Orikum, aktualisht Njësia Administrative Orikum

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Orikum, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) janë evidentuar gjithsej **31** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- në **17** raste, kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, dhe për këtë shkak janë deklaruar nëpunës civilë;
- në **6** raste janë deklaruar si nëpunës civil në periudhë prove, pasi kanë patur më pak se një vit;
- në **1** rast nuk është deklaruar statusi i punësimit, për shkak të mungesës së arsimit të lartë.

- 7 pozicione kanë rezultuar të lira.

b.1.3) Komuna Novoselë, aktualisht Njësia Administrative Novoselë

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në ish - Komunën Novoselë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kanë rezultuar gjithsej **13** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- në **12** raste, kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, në të njëjtin pozicion, dhe për këtë arsye janë deklaruar nëpunës civilë;
- në **1** rast është deklaruar nëpunës civil në periudhë prove, për shkak të periudhës së punësimit më pak se një vit.

b.1.4) Komunitat Qendër, aktualisht Njësia Administrative Qendër

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në ish - Komunën Qendër, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kanë rezultuar gjithsej **10** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- në **2** raste kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, dhe për këtë shkak u është bërë deklarimi i statusit si nëpunës civilë;
- në **8** raste, nuk është deklaruar statusi i punësimit për shkak:
 - të mospërmbushjes së kriterit arsimor
 - të largimit nga detyra
 - se nuk ka dosje personeli.

b.1.5) Komuna Shushicë, aktualisht Njësia Administrative Shushicë

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në ish - Komunën Shushicë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kanë rezultuar gjithsej **6** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga të cilat:

- në **5** raste kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, dhe për këtë arsye u është bërë deklarimi si nëpunës civilë;
- në **1** rast nuk është deklaruar statusi i punësimit, për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor.

► Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe në Komunitat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve

juridike të ligjit nr. 153/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) rezultojnë gjithsej **170** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar deklarinimin e statusit të punësimit nga ana e njësive përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, **170** rastet e deklarinimit të statusit të punësimit në Bashkinë Vlorë dhe në Komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, ndahen në këtë mënyrë:

- në **111** raste, kanë qënë punonjës ekzistues për më tepër se një vit, dhe për këtë arsye është bërë deklarinimi i statusit të nëpunësit civil, të pasqyruar në mënyrë të detajuar në Tabelën nr. 1 – *Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)*;
- në **14** raste kanë qënë punonjës të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar për një periudhë më pak se një vit, prandaj janë deklaruar nëpunës civilë në periudhë prove, të pasqyruar në mënyrë të detajuar në Tabelën nr. 2 - *Nëpunës civil në periudhë prove, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)*;
- në **24** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit;
- në **21** raste janë pozicione që kanë qënë të lira.

b.2) Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”

b.2.1) Bashkia Vlorë

Nga analiza e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo njësi ka qënë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 66, datë 20.12.2012 “*Mbi Strukturën Organizative të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse – viti 2013*”, të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton që kjo bashki, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka pasur **110** pozicione pune pjesë të shërbimit civil, nga të cilat vetëm **4** nëpunës kanë qënë të punësuar në respektim të procedurave të konkurrimit sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, kurse punonjësit e tjerë ishin punësuar nëpërmjet akteve të thjeshta të emërimit, pa kryer konkurrim.

Nëpunësit e punësuar rregullisht nëpërmjet kryerjes së konkurrimit, janë renditur ketu më poshtë:

1. *****, në pozicionin e punës *Drejtor i Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënies me Publikun*;
2. *****, në pozicionin e punës *Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social*;
3. *****, në pozicionin e punës *Specialist i nivelit të mesëm në Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social*;
4. *****, në pozicionin e punës *Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social*.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre, rezulton në katër rastet e mësipërme, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, për pranimin në shërbimin civil.

Me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse, me të drejtë për këto 4 raste, në muajin maj 2014, ka nxjerrë aktet e deklaramit të statusit, në përputhje me pikën 3 të nenit 67 të ligjit në fjalë dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*. Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Aneksin nr. 1 “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), që është pjesë e këtij raporti*.

b.2.2) Bashkia Orikum

Nga analiza e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organizatës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 15.01.2014 “*Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të Bashkisë Orikum për vitin 2014*”, të Këshillit të Bashkisë Orikum dhe nuk konstatohet asnjë rast, i punonjësve që janë rekrutuar sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

b.2.3) Komunat Novoselë, Qendër, Shushicë, aktualisht Njësi Administrative.

Komunat e mësipërme, të cilat aktualisht janë njësi administrative pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Vlorë, janë institucione që pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë përfshirë për herë të parë në shërbimin civil. Më parë marrëdhëniet e punës të punonjësve të tyre rregulloheshin në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ekzistonte ndonjë detyrim që punësimi të kryhej nëpërmjet procedurës së konkurrimit, qoftë edhe si procedurë e jashtme.

Statusi i nëpunësit civil për punonjësit e tyre, ka lindur për shkak të veprimit të nenit 67, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b.3) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

b.3.1) Bashkia Vlorë

Nga analiza e dokumentacionit që kishte në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkia Vlorë ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 66, datë 20.12.2012 “Mbi Strukturën Organizative të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse – viti 2013”, të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Sipas kësaj strukture organizative, kjo bashki ka pasur **110** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, prej të cilave në **96** raste, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme dhe me kontrata pune, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Megjithatë, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pavarësisht shkeljes ligjore të lejuar në lidhje me mënyrën e fillimit të marrëdhënies së punësimit, këta punonjës kanë përfitur statusin e nëpunësit civil, në bazë të dispozitës së nenit 67 të këtij ligji.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,” njësia e burimeve njerëzore ka kryer procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për gjithë punonjësit që ishin efektivë në datë 26.02.2014.

Gjendja e deklarimit të statusit të punësimit, konkretisht, paraqitet si më poshtë:

- Në **82** raste është bërë deklarimi i statusit të punësimit, prej të cilave:
 - **75** raste kanë qënë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.
 - **7** raste kanë qënë punonjës ekzistues të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit.
- Në **14** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit, nga të cilat:
 - për **4** raste për shkak të mospërbushjes së kriterit arsimor
 - për **8** rastet e punonjësve tek administratorët e qytetit
 - për **1** rast të punonjësit të IT
 - për **1** rast të punonjësit të tregjeve

Më poshtë po i analizojmë me hollësi rastet:

- Rastet e deklaramit të statusit të punësimit

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se nga **82 raste** të verifikuara:

- **75 raste**, siç u tha dhe më sipër, kanë qënë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.

Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë patur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.2.2014.

Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, si “nëpunës civilë”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin maj 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Aneksin nr. 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar - Bashkia Vlorë”, i cili është pjesë e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se në gjithë rastet e përmendura më sipër, njësia e burimeve njerëzore, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në dispozitën e nenit 67, pika 3 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

- Është evidentuar se në **7 raste**, janë konstatuar marrëdhënie pune, të cilat ditën e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë (në datë 26.2.2014) kishin kohëzgjatje më pak se 1 vit në atë pozicion.

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, në përputhje me nenin 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit si nëpunës civilë në periudhë prove.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në Aneksin nr.1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) Bashkia Vlorë”, i cili është pjesë e këtij raporti.

Konkluzion: Edhe për këto raste, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar drejt në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove.

- Rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit për shkak të nivelit arsimor

Gjatë procesit të verifikimit është konstatuar se në 4 raste, megjithëse pozicionet e punës ishin pjesë e shërbimit civil ishin emëruar punonjës të cilët nuk plotësonin kriterin e nivelit arsimor. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- *****, në pozicionin e punës “*Specialist Infrastruktura*”;
- *****, në pozicionin e punës “*Specialist Infrastruktura*”;
- *****, në pozicionin e punës “*Specialist i nivelit të lartë, topograf*”;
- *****, në pozicionin e punës “*Inspektor në Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve*”.

Në lidhje me këto raste, grupi i mbikëqyrjes konstaton se këta punonjës nuk plotësojnë kriteret për të mbajtur pozicionet përkatëse, për shkak të mungesës së arsimit të lartë.

Përmbushja e kriterit arsimor, është një element i domosdoshëm për lindjen ose ekzistencën e një marrëdhënie pune në shërbimin civil, kërkesë kjo e parashikuar shprehimisht, në shkronjën “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Për ata punonjës të bashkisë apo ish komunave, që nuk plotësojnë këtë kriter, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil*”, njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, sipas afateve të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore.

Në rastin konkret, megjithëse për personat e mësipërm është konstatuar mangësi e tillë, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar sipas ligjit, duke mos nxjerrë aktet e përfundimit të marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, dhe ata vijojnë të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse edhe sipas strukturës së miratuar nga Këshilli Bashkiak, me Vendimin nr. 24, datë 10.10.2015, “*Për miratimin e strukturës organizative tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të varësisë*”.

Në lidhje me pretendimin e parashtruar në shkresën nr. 803/1 prot., datë 09.02.2016, “*Informacion mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Vlorë*”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 771/4 prot., datë 03.03.2016, se këto pozicione pune përmbajnë të dy nivelet arsimore (i lartë/i mesëm), Komisioneri vlerëson se:

- Ky fakt është konstatuar nga grupi i punës, gjatë mbikëqyrjes, si mangësi në strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 66, datë 20.12.2012 “*Mbi Strukturën Organizative të Bashkisë dhe Institucioneve vartëse – viti 2013*”, të Këshillit të Bashkisë Vlorë, ç`ka i është njoftuar edhe njësisë përgjegjëse.
- Në kushtet kur, kjo mangësi nuk është korrigjuar ende edhe në strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak, me Vendimin nr. 24, datë 10.10.2015, “*Për miratimin e strukturës organizative tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve*

të varësisë”, dhe këta punonjës, konkretisht, *****, në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura” dhe *****, në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”, vazhdojnë të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse edhe sipas kësaj strukture, kjo situatë vlerësohet si e parregull.

- Përsa i përket, punonjësit *****, me strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak, me Vendimin nr. 24, datë 10.10.2015, “Për miratimin e strukturës organizative tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të varësisë”, rezulton se aktualisht është sistemuar në pozicionin “Topograf”, e për këtë arsye vlerësohet se kjo parregullsi është vendosur në korniza ligjore
- Përsa i përket, punonjëses *****, rezulton se ajo ka kaluar në një pozicion tjetër pune dhe më pas është liruar nga kjo detyrë dhe aktualisht nuk është pjesë e burimeve njerëzore të institucionit.

Konkluzion: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në këto raste, të rregullojë pasojat e veprimeve të kundraligjshme, duke nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të përfundimit të marrëdhënies së punësimit për këta punonjës konkretisht, *****, në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura” dhe *****, në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”.

Pozicionet e tyre të punës duhet të shpallen të lira, për t`u plotësuar më tej në përputhje me procedurat që parashikon ligji, në koherencë me strukturën aktuale të institucionit.

○ Rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit për administratorët e qytetit

Gjatë procesit të verifikimit të kategorisë së punonjësve të emëruar me kontratë pune, ashtu si e kemi vënë në dukje edhe më sipër në material, konstatohet se, në **8** raste, nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit, lidhur me personat që kanë ushtruar detyrën e administratorit të rajonit dhe specialistit të infrastrukturës, pranë administratorit të qytetit. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
2. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
3. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
4. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
5. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
6. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
7. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
8. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”.

Në lidhje me këto raste, Komisioneri vlerëson se, këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë dhe në përputhje me pikën 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarimin e statusit të punësimit.

Ky qëndrim duhet mbajtur për faktin se, në neni 47 “Funksionimi i nëndarjeve të bashkisë” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, përcaktohet se: “1. Në lagjet e bashkive funksionon

aparati administrativ. Struktura dhe numri i punonjësve të administratës së lagjes caktohet nga këshilli bashkiak. Në krye të aparatit administrativ të lagjes është administratori, i cili është nëpunës civil me epror të drejtpërdrejtë kryetarin e bashkisë. Trajtimi i punonjësve të tjerë të aparatit administrativ të lagjes i nënshtrohet ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.... ”. Në zbatim të dispozitës së mësipërme, ky status përshkruhet edhe në nenin 21 të Rregullores së Bashkisë Vlorë, ku thuhet shprehimisht se administratori i qytetit është punonjës me statusin e nëpunësit civil dhe ka epror direkt Kryetarin e Bashkisë.

Në lidhje me pretendimin e parashtruar në observacionet e institucionit, se ky pozicion pune është konsideruar si punonjës administrativ për dhënie shërbimi të drejtpërdrejtë, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar), Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit është bërë një referim i gabuar i bazës ligjore, pasi statusi i administratorit rregullohet nga dispozita e analizuar më sipër.

Konkluzion: Në këto rrethana, rezulton se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me ligjin në këtë drejtim dhe për të rregulluar pasojat, duhet të kryejë menjëherë procesin e deklarimit të statusit të punësimit sipas kërkesave ligjore për punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
2. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
3. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
4. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
5. *****, punësuar në pozicionin e punës “Administrator i rajonit”;
6. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
7. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
8. *****, punësuar në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për rastet e punonjësve ***** dhe *****, përkatësisht, “specialist IT” dhe “specialist tregu”.

Punonjësi *****, ka filluar punë me aktin e emërimit nr. 48, datë 07.04.2008, si “Specialist (mirëmbajtës rrjeti kompjuterik)” dhe aktualisht mban të njëjtin pozicion.

Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në të njëjtin pozicion pune, prandaj në kuptim të nenit 67, pika 3, të ligjit në fjalë, ka përfutuar statusin e nëpunësit civil, për shkak të ligjit.

Po kështu edhe punonjësi *****, i cili ka filluar marrëdhënien e punës në Bashkinë Vlorë, në datën 09.11.2009 në pozicionin “specialist i nivelit të lartë për tregjet”, fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në të njëjtin pozicion pune, prandaj në kuptim të nenit 67, pika 3 të ligjit në fjalë, ka përfutuar statusin e nëpunësit civil, për shkak të ligjit në atë pozicion.

Fakti që në datën 21.05.2014 (pra, pas lindjes së të drejtës për të përfituar statusin e nëpunësit civil), me dëshirën e tij, ka kaluar “Kryeinspektor i Policisë Bashkiake” (pra, ka dalë në një pozicion pune jashtë shërbimit civil) nuk duhet të shërbejë si pengesë që njësia përgjegjëse, të shpallë një të drejtë që atij i ka lindur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ky status është i lidhur me personin që e ka fituar dhe jo me pozicionin e punës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse në këto raste, ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë për sa sipër, duhet që njësia përgjegjëse të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit përkatësisht: për punonjësin ***** të deklarohet nëpunës civil në pozicionin “specialist IT” dhe për punonjësin ***** të deklarohet nëpunës civil në pozicionin “specialist i nivelit të lartë për tregjet” (pavarësisht se aktualisht, ai punon në një pozicion pune që nuk është pjesë e shërbimit civil).

b.3.2) Komuna Novoselë, aktualisht Njësia Administrative Novoselë

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 121, datë 24.01.2014 të Këshillit të Komunës Novoselë.

Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka pasur **13** pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Këto pozicione ishin të zëna nga punonjës të emëruar me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi këto institucione nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Pas fillimit të efekteve të ligjit aktual për shërbimin civil, në bazë të nenit 67 të tij, nga ana e njësisë së personelit, në muajin korrik 2014, është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit. Nga verifikimi ka rezultuar që për **12** raste, pasi është konstatuar se kishin në të njëjtin pozicion pune më shumë se një vit, është bërë deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civil dhe vetëm **1** rast është evidentuar që ka patur më pak se një vit, gjë që ka sjellë deklarimin e tij nëpunës civilë në periudhë prove.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse në këto raste, ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”. Në mënyrë të detajuar aktet e deklarimit të statusit, sipas personave dhe pozicioneve përkatëse paraqiten në Aneksin nr. 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, ish-Komuna Novoselë, që është pjesë e këtij raporti.

b.3.3) Komuna Qendër, aktualisht Njësia Administrative Qendër

Nga analiza e dokumentacionit të personelit, që i përket kësaj njësie administrative, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ajo ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 3, datë 31.01.2013 të Këshillit të Komunës Qendër.

Sipas kësaj strukture, kjo komunë ka pasur **10** pozicione pune të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, janë përfshirë në shërbimin civil.

Marrëdhëniet e punësimit në këto pozicione, janë lidhur nëpërmjet akteve individuale të emërimit ose me kontratë pune, pasi këto institucione nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimtimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Në kuadrin e plotësimit të detyrimit ligjor që rrjedh nga ligji i ri për shërbimin civil, njësia e personelit të komunës, në qershor 2014, ka kryer procesin e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit që kishin zënë vende punë të shërbimit civil, në përfundim të të cilit ka rezultuar si më poshtë:

- Për **2** raste është bërë deklarimi i statusit të punësimit;
- Në **3** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit, për shkak se nëpunësit e punësuar në ato pozicione nuk plotësonin kërkesën për nivelin arsimor;
- Në **2** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit për shkak të largimit nga puna, para përfundimit të procesit të deklarimit të statusit;
- Në **3** raste nuk është deklaruar statusi i punësimit për shkak se nuk kishte dokumentacion në dosje.

Më poshtë janë trajtuar hollësisht këto raste:

- Rastet e deklarimit të statusit të punësimit

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

Në **2** raste, është konstatuar se nëpunësit e punësuar në këto pozicione, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kishin më shumë se një vit në të njëjtin vend punë. Emrat e këtyre punonjësve, aktet që tregojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, emërtimin e pozicionit, etj. janë të shënuara hollësisht në Aneksin nr. 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ish-Komuna Qendër, që është pjesë e këtij raporti.

Konkluzion: Në këto raste, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore ka vepruar drejt duke respektuar të gjitha kriteret e vendosura në ligj dhe në aktet nënligjore që rregullojnë institutin e deklarimit të statusit të punësimit.

- Rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës.

Nga dokumentacioni i administruar që i përket kësaj njësie administrative, në 3 raste, janë emëruar punonjës në pozicione që i përkasin shërbimit civil, të cilët nuk plotësojnë kërkesën për nivelin arsimor, pasi janë me arsim të mesëm.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** (emëruar me urdhër nr. 10, datë 16.09.2013), në pozicionin e punës “*Inspektor Tatimesh*”;
- ***** (sipas librezës së punës, ka filluar në datë 01.07.1997), në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”;
- ***** (sipas librezës së punës, ka filluar në datë 01.05.2008) në pozicionin e punës “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”.

Për të tre këto raste, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt duke mos nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit.

Plotësimi i kriterit të nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e” të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është një kërkesë e domosdoshme për pranimin, ose mbajtjen e një pozicioni në shërbimin civil.

Në kushtet kur një punonjës nuk plotëson këtë kriter, bazuar në pikën 6, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, njësia e burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Në këtë rast, konstatohet se megjithëse është evidentuar si shkak i mos deklarimit të statusit të punësimit mungesa e arsimit përkatës, njësia përgjegjëse, nuk ka nxjerrë aktet e ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, dhe ata ende vijojnë të kryejnë detyrat funksionale në pozicionet përkatëse.

Konkluzion: Në këto raste, Komisioneri vlerëson se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Qendër, ndonëse ka vepruar drejt kur nuk i ka deklaruar nëpunës civilë punonjësit e mësipër për mungesë të arsimit përkatës, ka vepruar në kundërshtim me ligjin kur nuk ka vepruar për nxjerrjen e aktit të refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, gjë e cila duhet të kryhet menjëherë, duke shpallur të lira, pozicionet që do të krijohen nga ndërprerja e këtyre marrëdhënieve për t’u plotësuar më tej, në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën e ardhshme të Bashkisë Vlorë.

Ndërkohë, Komisioneri ka analizuar observacionet e institucionit në lidhje me këto raste dhe ka konstatuar se pretendimet nuk janë të shoqëruara me akte administrative që t’i provojnë ato.

Në këto rrethana, verifikimi i pretendimeve do të realizohet gjatë mbikëqyrjes në vazhdim, pas përfundimit të afatit ligjor të paralajmërimit të vendosur nga Komisioneri për të rregulluar situatën ligjore.

o Raste të mosdeklarimit të statusit për shkak se janë larguar nga puna.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se për punonjësit *****, punësuar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve” dhe *****, punësuar në pozicionin e punës “Jurist”, nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit, pasi, megjithëse në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ata kanë zenë pozicione pune të shërbimit civil, më pas janë larguar, pa u evidentuar shkak i largimit.

Konkluzion: Në kushtet si më sipër, kur grupi i punës nuk mundi të siguronte asnjë akt për mënyrën se si ka përfunduar marrëdhënia e punës për këta punonjës, pra nëse kjo marrëdhënie ka përfunduar për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, apo për arsye të tjera të parashikuara në ligj, i është kërkuar njësisë përgjegjëse, që të bëjë verifikimin dhe të shprehet në lidhje me këto raste.

Ndërkohë, Komisioneri ka analizuar observacionet e institucionit në lidhje me këto raste dhe ka konstatuar se pretendimet nuk janë të shoqëruara me akte administrative që t'i provojnë ato.

Në këto rrethana, verifikimi i pretendimeve do të realizohet gjatë mbikëqyrjes në vazhdim, pas përfundimit të afatit ligjor të paralajmërimit të vendosur nga Komisioneri për të rregulluar situatën ligjore.

o Raste të mosdeklarimit të statusit për shkak të mungesës së dokumentacionit në dosjen e personelit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se për punonjësit *****, në pozicionin e punës “Përgjegjëse Administrate”; *****, në pozicionin e punës “Inxhinier/Topograf” dhe *****, në pozicionin e punës “Inspektor Ndërtimi” megjithëse në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë qënë të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, nuk është lëshuar akti i deklarimit të statusit të punësimit për shkak të mungesës së dosjeve personale në zyrën e burimeve njerëzore.

Emrat dhe pozicionet e tyre të punës janë nxjerrë nga grupi i punës, duke analizuar listëpagesën e muajit shkurt 2014, sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 3, datë 31.01.2013 të Këshillit të Komunës Qendër.

Konkluzion: Në kushtet si më sipër, kur grupi i punës nuk mundi të siguronte asnjë akt për të analizuar procesin e deklarimit të statusit të punësimit për këta punonjës, Komisioneri i kërkon njësisë përgjegjëse, që brenda afatit që do të lihet pas dërgimit të këtij raporti, të bëjë verifikimin nëse këta persona janë akoma në marrëdhënie pune në pozicionet respektive dhe pas plotësimit të dosjeve të personelit me dokumentacionin e duhur të shprehet në lidhje me statusin e punësimit të tyre. Në përfundim të këtij procesi, për konkluzionet të vihet në dijeni Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

b.3.4) Komuna Shushicë, aktualisht Njësia Administrative Shushicë

Nga analiza e dokumentacionit të verifikuar në lidhje me këtë njësi administrative, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 22.01.2014 të Këshillit të Komunës Shushicë.

Sipas kësaj strukture, vetëm **6** pozicione pune janë përfshirë në shërbimin civil.

Edhe nëpunësit e punësuar në këto pozicione, ashtu siç e kemi evidentuar në Komunitat e tjera më sipër, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, pasi këto institucione para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimtimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga **6** rastet e trajtuara nga njësia përgjegjëse në lidhje me statusin e punësimit, si rezultat i të drejtës që ka lindur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, për **5** prej tyre, është deklaruar statusi i punësimit, ndërsa për **1** rast, nuk është deklaruar statusi, për shkak të mospërmbushjes të kriterit të nivelit të arsimit.

Pas analizës së dokumentacionit përkatës, u konstatua se në të **5** rastet për të cilat në muajin prill 2014, është vendosur deklarimi i statusit të nëpunësit civil për shkak të ligjit, punonjësit kanë qënë në të njëjtin pozicion pune më tepër se një vit, e për këtë shkak, në bazë të pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me të drejtë ata janë konsideruar nëpunës civilë.

Në mënyrë të detajuar pozicionet dhe nëpunësit përkatës, përshkruhen në Aneksin nr. 1 “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ish-Komuna Shushicë, që është pjesë e këtij raporti.*

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar drejt në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si nëpunës civilë për këtë kategori punonjësish, pasi janë respektuar të gjitha kriteret e vendosura në ligj dhe në aktet nënligjore që rregullojnë institutin e deklarin të statusit të punësimit.

○ Rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit.

Në përfundim të procesit të verifikimit u konstatua se vetëm në rastin e punonjësit ***** emëruar me kontratë nr. 27, datë 01.08.2013, në pozicionin e punës “*Përgjegjës Tatim Taksash*”, nuk është bërë deklarimi i statusit të nëpunësit civil, pasi ai nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor, për pozicionin e punës ku ai ishte emëruar.

Siç kemi thënë dhe në raste të tjera të ngjashme, niveli arsimor është një kërkesë ligjore e cila nëse nuk plotësohet, në bazë të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.*

Në rastin e këtij punonjësi, konstatohet se njësia përgjegjëse, nuk ka nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe ai ende vijon të kryejë detyrat funksionale në pozicionin përkatës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Shushicë, me të drejtë, për mungesë të arsimit përkatës, nuk ka bërë deklarinim e statusit të punësimit për këtë punonjës, por ka shkelur ligjin me mosveprimin për nxjerrjen e aktit të refuzimit të statusit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës për këtë shkak, prandaj për të rregulluar situatën, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë, duhet të vendosë në përmbushje të këtij detyrimi ligjor dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë, për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat e nenit 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën e ardhshme të Bashkisë Vlorë.

Ndërkohë, Komisioneri ka analizuar observacionet e institucionit në lidhje me këtë rast dhe ka konstatuar se pretendimet nuk janë të shoqëruara me akte administrative që t'i provojnë ato.

Në këto rrethana, verifikimi i pretendimeve do të realizohet gjatë mbikëqyrjes në vazhdim, pas përfundimit të afatit ligjor të paralajmërimit të vendosur nga Komisioneri për të rregulluar situatën ligjore.

b.4) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vakant)

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në Bashkinë Vlorë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka patur **14 pozicione pune të paplotësuara**, të cilat në mënyrë analitike renditen më poshtë:

1. *Administrator i qytetit;*
2. *Specialiste i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun;*
3. *Specialist i Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun;*
4. *Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore;*
5. *Inspektor i kontabilitetit tatimor në Sektorin e Pranimit të Kontabilitetit Tatimor;*
6. *Specialist i nivelit të lartë (përgjegjës Sektori) në Sektorin e Kontrollit dhe Sekuestros;*
7. *Specialist i nivelit të lartë (përgjegjës Sektori) në Sektorin e Borxhit Tatimor;*
8. *Specialist tregu në Sektorin e Tregjeve Publike;*
9. *Specialist i nivelit të lartë (arkiva) në Drejtorinë e Projektimit dhe Urbanizimit;*
10. *Specialist i nivelit të lartë (arkitekt-urbanist) në Drejtorinë e Projektimit dhe Urbanizimit;*
11. *Inspektor i Kontrollit Veterinar në Sektorin e Veterinarisë;*
12. *Inspektor i Kontrollit Veterinar në Sektorin e Veterinarisë;*
13. *Specialist i nivelit të mesëm në Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social;*
14. *Specialist i nivelit të mesëm në Drejtorinë e Ndhmës dhe Shërbimit Social.*

Karakteristika më të hollësishme për këto pozicione pune të paplotësuara, janë të pasqyruara në Aneksin nr. 1 “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Bashkia Vlorë, që është pjesë e këtij raporti.*

Kurse, në njësitë administrative Novoselë, Qendër dhe Shushicë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nuk kishte asnjë pozicion pune të paplotësuar. Në ish – Bashkinë Orikum ka patur 7 pozicione pune të paplotësuara.

II. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore

Në bazë të, pikës 2, të Kreut II, të Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, njësitë përgjegjëse në institucionet e pushtetit vendor, duhej të përfundonin procesin e lëshimit të akteve të deklarimit të statusit jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe lejon të drejtën e shtyrjes së këtij afati një herë të vetme nga institucioni, për shkaqe të arsyeshme, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.*

Në njësitë e pushtetit vendor që aktualisht përfshihen në juridiksionin e Bashkisë Vlorë, konstatohet se ky proces është kryer në periudhën maj – korrik 2014, pra brenda afatit ligjor, gjë e cila flet për një punë të kujdesëshme nga ana e njësive përgjegjëse në zbatimin e kërkesave të ligjit.

III. Pasqyrimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit, grupi i punës verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruar në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që regullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumentat e identifikimit (fotokopje e pasaportës); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (çertifikata e gjëndjes familjare); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (çertifikata kualifikimi), si dhe aktet që provojnë

procesin e deklarimit të statusit të punësimi. Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në Aneksin nr. 2.

b. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Konkluzion: Sa më sipër, konstatohet se dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, që është edhe përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

IV. Situata aktuale në lidhje me administrimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, në raport me situatën në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Duke analizuar statistikat e prodhuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rezulton se, situata aktuale, e krijuar pas ndryshimeve të ndodhura për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, mbështetur në ligjin nr. 30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, është e materializuar në strukturën e miratuar nga Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 24, datë 10.10.2015, “Për miratimin e strukturës organizative tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të varësisë”.

Bazuar në këtë strukturë rezultojnë në shërbimin civil 114 punonjës nga 338 punonjës në total. Kjo situatë është e evidentuar në mënyrë të detajuar në Aneksin nr. 3 - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil, sipas Strukturës Organizative Tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2015”, që është pjesë e këtij raporti.

Ndërkohë, situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që përkon me datën 26.02.2014, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Tabelë : *Situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014.*

Nr.	Institucioni	Punonjës gjithsej	Pozicione në shërbimin civil
1	Bashkia Vlorë	219	110
2	Komuna Novoselë	58	13
3	Komuna Qendër	70	10
4	Komuna Shushicë	32	6
5	Bashkia Orikum	55	31
Totali		434	170

Nga analiza e të dhënave të paraqitura më sipër, rezulton se numri total i punonjësve të Bashkisë Vlorë së bashku me komunat që janë bërë pjesë e kësaj njësie të pushtetit vendor, nga **434 punonjës** që ishin në strukturat e mëparshme, tashmë është **338 punonjës**, pra është zvogëluar me rreth **22%**, ndërsa pozicionet e shërbimit civil nga **170 pozicione** gjithsej, aktualisht, me strukturën provizore të viti 2015, janë **114 pozicione** pune në shërbimin civil, nga ku rezulton se kemi një ulje të numrit të punonjësve në masën **33%**.

Nga sa më sipër konstatoj se ky institucion është përfshirë në proces ristrukturimi, i cili në thelbin e tij përbëhet jo vetëm nga shkurtime në pikëpamjen numerike por dhe riorganizime nga pikëpamja e përmbajtjes të pozicioneve të punës. Për këtë arsye, njësia përgjegjëse e Bashkisë Vlorë duhet të tregojë kujdes në realizimin e procedurës së ristrukturimit, duke mbajtur parasysh kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike.

Në këto rrethana, sjellim në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, se procesi i ristrukturimit të institucionit, fillon të materializohet me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe në përmbajtje përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësia përgjegjëse gjatë implementimit të tij, ndër të cilat përmendim aktin e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e lirimimit të nëpunësve që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës; aktin e pranimit të propozimit të komisionit të ristrukturimit; aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, etj.

Njësia përgjegjëse është gjithashtu, struktura që ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirin nga shërbimi civil, të nëpunësve që i ka dalë i tepërt pozicioni i punës, ose i ka ndryshuar përshkrimi i punës.

Konkretisht, pas miratimit të numrit të përgjithshëm të personelit të Bashkisë nga Këshilli Bashkiak dhe pas miratimit të strukturës provizore nga Kryetari i Bashkisë, njësia përgjegjëse duhet të udhëheqë procesin e ristrukturimit duke ndjekur këtë rend pune:

a) Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe

trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke karahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014 i Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithëshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

b) Komisioni i Ristrukturimit, duhet të paraqesë propozimet për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

c) Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirim nga shërbimi civil, apo riemërimin në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, që duhet të merret nga njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit.

Në këtë rast, akti i emërimit duhet të jetë nominal për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni i punës dhe kategoria e pagës.

Duhet të tregohet kujdes, që në rastet e uljes në detyrë të punonjësit, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

d) Hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashkrimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që përbën një proces kompleks dhe që është kusht pa të cilin, nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi i tyre, apo rregjistrimi i tyre në listën e pritjes.

Kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës, çka është një rubrikë e rëndësishme e që përfshihet në formularin e përshkrimit të punës.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet sidomos për respektimin e të gjitha të drejtave që parashikon pika 7 e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, për punonjësit të cilët lirohen nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ndër të cilat e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohëshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, me përfundimin e procesit të ristrukturimit, njësia përgjegjëse duhet të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar, ku të paraqesë situatën pas ristrukturimit, ku të materializohet sistemimi i punonjësve të cilët e gëzojnë statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë, në lidhje me zbatimin të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme respektive për Bashkinë Vlorë, dhe Komunat Novoselë, Qendër dhe Shushicë, aktualisht njësi administrative të Bashkisë Vlorë, të cilat janë pjesë e këtij raporti.

- ***Aneksi 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civilë, i ndryshuar, (data 26.02.2014)”.*
- ***Aneksi 2** - “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civilë, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.*
- ***Aneksi 3** - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil, sipas Strukturës Organizative Tranzitore të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2015”.*

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA